



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 23 prill 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake lidhur me Raportin e Këshillit
të Evropës, Afatet Hetimore, dhe Mandatin Kohor**

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagendra

I. HYRJE

1. Akuzat e paraqitura në Aktakuzë¹ janë të lidhura me Raportin e Këshillit të Evropës ('Raporti i Këshillit të Evropës'),² dhe, rrjedhimisht, janë brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('DHSK'). Argumentet në të kundërt nuk marrin parasysh formulimin e qartë që ka Ligji³ dhe shtrembërojnë Raportin e Këshillit të Evropës. Rrjedhimisht, ato duhen rrëzuar.

2. Po kështu, janë të pathemelta parashtrimet e Mbrojtjes së THAÇIT lidhur me periudhën e lejuar për hetime penale, dhe mandatin kohor të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS')⁴. Ato mbështeten në dispozita ligjore të pazbatueshme dhe anashkalojnë vendimet me fuqi detyruese të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('DHSGJK').

¹ Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020', KSC-BC-2020-06/F000134, 11 dhjetor 2020, Konfidenciale ('Aktakuza'). *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Versionit të Redaktuar Publik të Parashtrimit të Versioneve të Korrigjuara dhe të Redaktuara Publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të, KSC-BC-2020-06/F00045/A01, 4 nëntor 2020, Rreptësisht konfidenciale dhe *Ex Parte*.

² Council of Europe, Parliamentary Assembly, Committee on Legal Affairs and Human Rights, Report: Inhumane treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo, Doc.12462, 7 January 2011 ('CoE Report') (Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Komisioni për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Raport: Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, Doc.12462, 7 janar 2011 ('Raporti i Këshillit të Evropës')). Përveçse kur përcaktohet ndryshe, të gjitha citimet e Raportit të Këshillit të Evropës janë prej memorandumit shpjegues të Raportuesit.

³ Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'). Të gjitha referencat për 'nenin' ose 'nenet' në këtë dokumenti janë prej Ligjit, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

⁴ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 1(b)-(c), 44-59.

3. DHSK-ja ka juridiksion për të gjitha pikat e Aktakuzës, dhe kërkesat e Mbrojtjes⁵ duhen rrëzuar tërësisht.

II. PARASHTRIMET

A. JURIDIKSIONI LËNDOR ËSHTË I QARTË

4. Kushtetuta, Ligji dhe Raporti i Këshillit të Evropës përcaktojnë qartë dhe përforcojnë në mënyrë të ndërsjellë juridiksionin lëndor të DHSK-së. Kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj tij mbështeten zakonisht në (i) përpjekjet pa bazë për sajimin e një konflikti mes Ligjit dhe Kushtetutës, dhe (ii) interpretimin e ngushtë dhe pa bazë të Raportit të Këshillit të Evropës.

5. Neni 162(1) i Kushtetutës përcakton se (i) themelimi i DHSK-së dhe ZPS-së synon t'i mundësojë Kosovës të përmbushë detyrimet e saj ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, dhe (ii) juridiksioni i DHSK-së rregullohet përmes këtij neni dhe me ligj të veçantë. Në pajtim me këtë, Ligji i jep DHSK-së juridiksion

⁵ Kjo përgjigje trajton posaçërisht: Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit - Diskriminim, KSC-BC-2020-06/F00216, 12 mars 2021 ('Kërkesa e THAÇIT'), para. 1(a), 3-43; Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit - Diskriminim, KSC-BC-2020-06/F00219, 15 mars 2021 ('Kërkesa e SELIMIT'), para. 1, 4; Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Krasniqit mbi Juridiksionin, KSC-BC-2020-06/F00220, 15 mars 2021 (me shtojcë) ('Kërkesa e KRASNIQIT'). Argumentet në këto kërkesa lidhur me ndërmarrjen kriminale të përbashkët dhe me politikën e pretenduar diskriminuese në punësim të DHSK-së trajtohen në përgjigje të veçanta.

lëndor, ndër të tjera, edhe për krime lufte ose krime kundër njerëzimit 'të cilat lidhen me' Raportin e Këshillit të Evropës.⁶

6. Siç paraqitet më poshtë,⁷ bazuar në një keqinterpretim qëllimisht të ngushtë të Raportit të Këshillit të Evropës, Mbrojtja në fakt përpiket të pretendojë se juridiksioni i DHSK-së përfshin vetëm pretendimin për krime të organizuara në Shqipëri në mesin e vitit 1999. Ky pretendim nuk ka bazë, dhe – në përpjekje për ta sajuar atë – Mbrojtja nuk merr parasysh formulimet e qarta, anashkalon parimet bazë për interpretim, dhe kërkon të nxjerrë përfundime të pagjasa.

7. Për shembull, Mbrojtja vë theks të madh mbi faktin se neni 162 i Kushtetutës përkthyer se arsyeja e themelimit të DHSK-së është që Kosova të 'përmblusë detyrimet ndërkombëtare në lidhje me [Raportin e Këshillit të Evropës]'.⁸ Mirëpo ky formulim nuk përmban asnjë nga kufizimet që kërkon të deduktojë Mbrojtja në të,⁹ as mbështet asnjë prej përfundimeve që ajo kërkon të nxjerrë prej tij. Në veçanti, është i pathemeltë pretendimi se neni 162(1) i Kushtetutës synonte në njëfarë mënyre të kufizonte apo korrigjonte kuadrin e hetimeve të TFHS-së.¹⁰ Po të kishte qenë ky synimi, dhe duke pasur parasysh se në atë kohë dihej publikisht se cili ishte kuadri i

⁶ Neni 6(1). *Shih gjithashtu* nenin 1(2), i cili gjithnjë u referohet krimeve 'që ndërlidhen me ato që janë raportuar në [Raportin e Këshillit të Evropës]'.

⁷ Pjesa II.B më poshtë.

⁸ Neni 162(1) i Kushtetutës. *Shih* Kërkesën e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 24, 28-30; Kërkesën e SELIMIT, KSC-BC-2020-06/F00219, para.4 (2); Kërkesën e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00220, para. 62.

⁹ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 9-12, 32, 38 (ku pretendohet se 'ligjvënësit ishin autorizuar të krijojnë dhomat e specializuara vetëm lidhur me pretendimet e Raportit të Martit, për të cilat kishte kryer hetime TFHS-ja').

¹⁰ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 13-22.

hetimeve të TFHS-së,¹¹ atëherë do të kishte qenë e domosdoshme që ky formulim ta përkufizonte shprehimisht se si duhej lexuar Raporti i Këshillit të Evropës ose të identifikonte konkretisht pretendimet të cilat do të përbënin fushëveprimin e lejuar të juridiksionit lëndor të DHSK-së. Një gjë e tillë nuk është bërë. Përkundrazi, ai nën shprehimisht ia kalon Ligjit kompetencën për qartësimin e mëtejshëm të juridiksionit.

8. Pa argumente mbështetëse, Mbrojtja e THAÇIT pretendon se interpretimi i ngushtë që i bën juridiksionit lëndor është ai që synonte Kuvendi i Kosovës.¹² Megjithatë, mbështetja në historinë e hartimit të ligjit kundrejt formulimit të qartë ligjor nuk është interpretim i duhur ligjor.¹³

9. Për më tepër, interpretimi i Mbrojtjes kundërshtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga formulimi i qartë i Ligjit. Ligji u miratua nga Kuvendi të njëjtën ditë si edhe neni 162 i Kushtetutës, dhe dispozitat e tij juridiksionale përcaktojnë se: (i) juridiksioni kohor i DHSK-së përfshin periudhën nga 1998 deri në 2000, dhe jo vetëm mesin e vitit 1999;¹⁴ (ii) juridiksioni territorial përfshin krimet në Kosovë, dhe jo vetëm

¹¹ Shtojca II e Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Deklarata e datës 29 korrik 2014 e Kryeprokurorit të Task Forcës Hetimore Speciale, S/2014/558, 1 gusht 2014.

¹² *Shih* Kërkesën e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para.29 (pohohet pa citim: 'debatet në Kuvendin Kombëtar mbi amendamentin kushtetues konfirmojnë se synimi ishte të kufizohej juridiksioni i DHSK-së në pretendimet e Raportit të Martit dhe të DHSK-ja të mos zgjaste më shumë se pesë vjet'). Nga transkriptet e debatit të 3 gushtit 2015 të Kuvendit mbi Amendamentin Kushtetues dhe Ligjin, nuk lihet të kuptohet nga asnjë folës, përfshirë Hashim THAÇIN, se ligjvënësit synonin të kishte kufizime të tilla (Kuvendi i Kosovës, Transkriptet, 3 gusht 2015 (seancat që filluan në orën 10:00, 21:00, dhe 23:15)).

¹³ *Shih* Article 32 of the Vienna Convention on the Law of Treaties, 1155 UNTS 331, 23 May 1969.

¹⁴ Neni 7.

në Shqipëri;¹⁵ dhe (iii) parashihet ndjekja penale e krimeve ndërkombëtare,¹⁶ dhe jo vetëm i krimeve të organizuara.

10. Këto dispozita nuk ka si të jenë më të qarta. Në rast se në atë kohë do të kishin ekzistuar dyshime lidhur me përputhshmërinë e Ligjit me Kushtetutën, Kuvendi ose Presidenti do ta kishin dërguar atë në gjykatë për vlerësimin e kushtetutshmërisë.¹⁷ Një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Dispozitat e Ligjit, të lexuara së bashku me nenin 162 të Kushtetutës dhe me Rregulloren, duhen interpretuar në mënyrë harmonike sa herë që është e mundur.¹⁸ Mbrojtja paraqet interpretime mospërputhëse të cilat shfuqizojnë formulimin e qartë të Ligjit, dhe argumente të tilla duhet të hidhen poshtë.

11. Nuk ka bazë as për pretendimin e Mbrojtjes se Ligji duhet lexuar në mënyrë të tillë që të përjashtohet çdo përkim juridiksioni me çështjet që janë brenda juridiksionit të TPNJ-së.¹⁹ Është e qartë se as Kushtetuta dhe as Ligji nuk e kufizojnë juridiksionin e DHSK-së, duke iu referuar TPNJ-së.²⁰ Përkundrazi, duket se Ligji parashikon konkretisht mundësinë e një përkimi material të gjerësishëm si, për shembull, përmes dispozitave të cilat (i) garantojnë parimin *non-bis-in-idem* ndërmjet TPNJ-së dhe

¹⁵ Neni 8.

¹⁶ Nenet 13 dhe 14.

¹⁷ Neni 113(2)(1) i Kushtetutës.

¹⁸ *Shih* Scalia and Garner, *Reading Law: The Interpretation of Legal Texts* (Thomson Reuters 2012), chapter 27 (Harmonious-Reading Canon: dispozitat e një teksti duhen interpretuar në mënyrë që i bën përpouthëse, jo kundërthënëse). *Shih gjithashtu* chapter 5 (Presumption of Validity: interpretimi që mbështet ka epërsi mbi interpretimin që rrëzon (*ut res magis valeat quam pereat*)).

¹⁹ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 14-16, 31; Kërkesa e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00220, para. 65(b).

²⁰ Përkundrazi, siç paraqitet më lart, dispozitat e qarta juridiksionale përfshijnë aspekte të cilat mund të ishin pjesë e juridiksionit të TPNJ-së.

DHSK-së;²¹ dhe (ii) përcakton shprehimisht se provat e mbledhura nga TPNJ-ja janë të pranueshme në DHSK.²² Po të ishin të vërteta pretendimet e Mbrojtjes lidhur me synimin e ligjvënësve, këto dispozita do të ishin të tepërta, dhe do të shkeleshin sërish parimet e interpretimit të qartë ligjor.

12. Për më tepër, duke pasur parasysh shqetësimin e qartë të Raportit të Këshillit të Evropës lidhur me pandëshkueshmërinë ekzistuese,²³ nuk ka gjasa sugjerimi se u krijua një mandat krejtësisht i ndryshëm nga ai i TPNJ-në. Kur Ligji ishte në shqyrtim e sipër në vitin 2015, TPNJ-ja ishte afër përfundimit të strategjisë së vet përmbyllëse. Ishte e qartë se TPNJ-ja nuk ishte në gjendje të merrte përsipër çështje të tjera penale të Kosovës, që do të thotë se argumentet e Mbrojtjes varen nga kalimi i juridiksionit nga DHSK-ja në një institucion që nuk ishte i disponueshëm.

13. Në fund, janë të pathemelta pretendimet e Mbrojtjes se mandati i DHSK-së është vetëm për krimet e posaçme që shtjellohen në Raportin e Këshillit të Evropës. Përkundrazi, Ligji përcakton shprehimisht se juridiksioni lëndor përfshin edhe krime që 'lidhen me' Raportin e Këshillit të Evropës.²⁴ Kështu bëhet e qartë se nuk kërkohet të ketë përkim të plotë me incidentet e përshkruara në Raportin e Këshillit të Evropës.²⁵ Po të kishin dashur hartuesit ta kufizonin mandatin e DHSK-së vetëm për

²¹ Neni 17.

²² Neni 37.

²³ Raporti i Këshillit të Evropës, Summary; Draft Report, para.14; Explanatory Memorandum, para. 7, 69, 169-174, 176.

²⁴ Nenet 1(2) dhe 6. Gjithashtu, në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes (Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 25-26), neni.1(2) i Ligjit nuk e kufizon juridiksionin e DHSK-së. Siç del qartë nga pjesa 'Fusha e veprimit dhe qëllimi të ligjit' ku gjendet kjo dispozitë, neni 1(2) është përshkruar, jo juridiksional. Aty shpjegohet qëllimi i miratimit të Ligjit. Kur përshkruan se pretendimet e Raportit të Këshillit të Evropës kanë qenë objekt i hetimeve penale të TFHS-së, dispozita pasqyron thjesht rrethanat përkatëse, duke mos vendosur kufizime të tjera juridiksionale.

²⁵ *Contra* Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 25, 33; Kërkesa e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00220, para. 55, 64-65, 67.

veprat penale të diskutuara në Raportin e Këshillit të Evropës, do të ishte përdorur një formulim më i drejtpërdrejtë. Është logjike që nuk është bërë një gjë e tillë. Kufizimi i juridiksionit të DHSK-së vetëm për incidentet e diskutuara në një raport të shkruar para kryerjes së një hetimi penal do të kishte qenë i paarsyeshëm, dhe mund t'i shërbente pandëshkueshmërisë.

14. Sidoqoftë, siç përshkruhet më poshtë, akuzat e Aktakuzës përfshihen plotësisht brenda juridiksionit lëndor të DHSK-së.

B. AKUZAT PËR VEPRAT PENALE NË AKTAKUZË KANË LIDHJE ME RAPORTIN E KËSHILLIT TË EVROPËS

15. Sipas Aktakuzës, të akuzuarit ishin pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët dhe kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë.²⁶ Aktakuza përmban hollësi të incidenteve të persekutimit, burgosjes/ndalimit arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore/trajtimin mizor, torturës, vrasjes së paligjshme, dhe zhdukjeve me forcë në më shumë se 40 objekte të ndalimit në të gjithë Kosovën dhe në veri të Shqipërisë ose lidhur me to.²⁷ Siç paraqitet më poshtë, këto akuza – përfshirë krimet, synimin e përbashkët, vendin e kryerjes dhe metodat e përdorura, kryesit, dhe viktimat, si dhe shtrirjen kohore dhe gjeografike të këtyre ngjarjeve – lidhen qartësisht me Raportin e Këshillit të Evropës. Në fakt, ato bien brenda fushëveprimit të

²⁶ Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F000134, para.32. 'Kundërshtarët' përkufizohen në Aktakuzë.

²⁷ Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F000134, para. 59-93. *Shih gjithashtu* Listat A-C.

aspekteve të përshkruara shprehimisht në raport, edhe pse një gjë e tillë nuk është e nevojshme për të përmbushur kriteret e nenit 6(1).²⁸

16. Mbrojtja argumenton se Raporti i Këshillit të Evropës ka të bëjë me krime të organizuara, dhe jo me krime lufte apo krime kundër njerëzimit.²⁹ S'ka dyshim se disa formulime dhe pretendime të Raportit të Këshillit të Evropës lidhen me krimin e organizuar. Megjithatë, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,³⁰ raporti përmban shprehimisht edhe pretendime të krimeve ndërkombëtare.³¹ Në fakt, përmbledhja e Raportit shpreh shqetësimin se '[ë]shtë kryer një hetim i pamjaftueshëm për lidhjen midis anëtarëve të UÇK-së dhe krimeve të luftës të kryera ndaj serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.³² Në veçanti, përshkruhet se 'tiparet e përgjithshme' të ndalimit nga ana e UÇK-së duket se arrijnë pragun e krimeve të luftës.³³ Ky përfundim mbështetet nga përshkrimet e gjerësishme të rrahjeve dhe të keqtrajtimit 'pas asnjë shkak'.³⁴ Përveç përshkrimit të gjerësishëm të ndalimit (përfshirë atë arbitrar)³⁵ dhe të trajtimit çnjerëzor, në Raportin e Këshillit të Evropës

²⁸ *Shih* para. 13 më lart.

²⁹ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 9, 39-41; Kërkesa e SELIMIT, KSC-BC-2020-06/F00219, para.4 (pika 7); Kërkesa e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00220, para. 60, 67.

³⁰ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.101. janë thjesht të pasakta pohimet e Mbrojtjes së THAÇIT dhe Mbrojtjes së SELIMIT se raporti nuk përmend krime lufte ose krime kundër njerëzimit. Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 39; Kërkesa e SELIMIT, KSC-BC-2020-06/F00219, para. 4 (pika 7).

³¹ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, Summary; Draft Resolution, paras 11 and 19.6; Explanatory Memorandum, para. 7, 8, 68, 101, 113.

³² Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, Summary. *Shih gjithashtu* Raportin e Këshillit të Evropës, Doc.12462, Draft Resolution, para.11.

³³ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.101.

³⁴ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.112.

³⁵ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.117.

përmenden në mënyrë të veçantë vrasjet e paligjshme,³⁶ tortura,³⁷ dhe zhdukjet me forcë.³⁸

17. Si Aktakuza, edhe Raporti i Këshillit të Evropës përqendrohet në krime të kryera në objektet e ndalimit të kontrolluara nga UÇK-ja ose lidhur me to. Në mënyrë të ngjashme, Raporti i Këshillit të Evropës përmend edhe aspekte të tjera të çështjes penale kundër të akuzuarve – si për shembull ekzistencën e strukturave të zbulimit të UÇK-së dhe përdorimin e tyre për kryerjen e krimeve,³⁹ si dhe mënyrën se si objektet e ndalimit ishin pjesë e një rrjeti të bashkërenduar.⁴⁰

18. Në Raportin e Këshillit të Evropës zënë vend të dukshëm personat që dyshohej se ishin ‘bashkëpunëtorë’, si dhe të tjerë që perceptoheshin si kundërshtarë, të cilët u vunë në shënjestër në mënyrë të veçantë.⁴¹ Për shembull, Raporti i Këshillit të Evropës përshkruan një nëngrup personash të identifikuar për t’u ndaluar, të cilët ishin ‘civilë shqiptarë – si dhe disa rekrutë të UÇK-së – të dyshuar si ‘bashkëpunëtorë’ ose tradhtarë, ose duke u bazuar mbi pretendimin se kishin spiunuar për serbët, ose sepse mendohej se i përkisnin, ose përkrahnin, rivalët politikë dhe ushtarakë të UÇK-së,

³⁶ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, Draft Resolution, para.12; Memorandumi Shpjegues, para. 19, 124, 174.

³⁷ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para. 128, 173, 174.

³⁸ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.137.

³⁹ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.52, poshtëshënimi.22.

⁴⁰ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.98.

⁴¹ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, Projekt-rezoluta, para.11; Explanatory Memorandum, para. 4, 44 (ku vërehet se mendohet se janë shpenzuar më shumë burime dhe kapital politik ndaj rivalëve shqiptarë), 52, 86 (ku u referohet ‘atyre që perceptohen si rivalë, tradhtarë, dhe personave të dyshuar si ‘bashkëpunëtorë’ të serbëve), 111.

veçanërisht LDK-në dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK) të sapokrijuara'.⁴²

19. Mbrojtja argumenton se Raporti i Këshillit të Evropës është vetëm për krimet e kryera në Republikën e Shqipërisë.⁴³ Është e qartë se Raporti i Këshillit të Evropës përqendrohet në krimet e kryera në Shqipëri, përfshirë objektet e ndalimit në Kukës dhe Cahan të cilat janë pjesë e aktakuzës,⁴⁴ por një gjë e tillë nuk bëhet në mënyrë ekskluzive. Si fillim, vetë titulli i raportit është 'Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë'.⁴⁵ Gjithashtu, Raporti i Këshillit të Evropës u referohet krimeve në pjesë të ndryshme të Kosovës,⁴⁶ dhe raportuesi vizitoi vende të varreve masive në Kosovë gjatë përgatitjes së tij.⁴⁷ Projekt-rezoluta që shoqëron Raportin e Këshillit të Evropës bën thirrje për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të Shqipërisë dhe Kosovës me EULEX-in, ndër të tjera, për 'zbulimin e së vërtetës rreth krimeve të kryera në Kosovë'.⁴⁸

20. Mbrojtja argumenton se, për shkak se Raporti i Këshillit të Evropës merret me ngjarje dhe akte që kanë ndodhur 'më së shumti' nga vera e vitit 1999 e më tej,⁴⁹ krimet

⁴² Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.111.

⁴³ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 9, 34-36; Kërkesa e SELIMIT, KSC-BC-2020-06/F00219, para.4 (pika 5); Kërkesa e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00220, para.59.

⁴⁴ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para. 115-28.

⁴⁵ Theksimi i shtuar.

⁴⁶ Për shembull Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para. 4, 23, 72, 175 (ku përshkruhet se ishte caktuar detyra për të hetuar 'për pretendimin e shkeljeve të drejtave të njeriut që thuhet se kanë ndodhur në Kosovë në periudhën që përfshijnë akuzat' (theksimi i shtuar)).

⁴⁷ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.14, poshtëshënimi.11.

⁴⁸ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, Draft Resolution, para.19.5.1.

⁴⁹ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.4.

e kryera më parë dalin jashtë kuadrit të tij.⁵⁰ Mirëpo vetë fjalët ‘më së shumti’ tregojnë se Raporti i Këshillit të Evropës përfshin krime përtej verës së vitit 1999. Për shembull, në Raportin e Këshillit të Evropës diskutohen ndërmarrjet kriminale të UÇK-së në Shqipëri që nga ‘më së voni 1998’.⁵¹ Në pjesë të tjera, në përmbledhjen që pasqyron juridiksionin kohor që më pas u miratua me anë të Ligjit, Raporti i Këshillit të Evropës përshkruan se si disa udhëheqës të UÇK-së:

Kanë urdhëruar – dhe në disa raste edhe kanë mbikëqyrur personalisht – vrasje, ndalime, rrahje dhe marrje në pyetje në rajone të ndryshme të Kosovës dhe, çka është me interes të veçantë për punën tonë, në kontekstin e operacioneve të drejtuara nga UÇK-ja në territorin e Shqipërisë nga viti 1998 deri në 2000.⁵²

21. Në fund, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes se vetëm personat e përmendur me emër në Raportin e Këshillit të Evropës janë brenda juridiksionit të tij⁵³, në fakt aty përshkruhen shprehimisht në mënyrë joshteruese edhe kryesit e mundshëm,⁵⁴ duke e lënë të hapur mundësinë e identifikimit të të tjerëve. Faktikisht, do të ishte i palogjikshëm dhe në kundërshtim me interesat e drejtësisë çdo interpretim tjetër i cili do t’i kufizonte akuzat vetëm për personat e identifikuar si individë me interes përpara kryerjes së hetimeve penale.

22. Krimet e akuzave duhet të ‘lidhen me’ Raportin e Këshillit të Evropës. Siç është demonstruar më lart, ndërlidhja reale është edhe më e fuqishme. Akuzat e paraqitura në Aktakuzë pasqyrohen dhe përshihen në pretendimet e qarta të Raportit të Këshillit

⁵⁰ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 10, 37-38; Kërkesa e SELIMIT, KSC-BC-2020-06/F00219, para.4 (pika 6); Kërkesa e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00220, para.58.

⁵¹ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.56.

⁵² Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para.72.

⁵³ Kërkesa e SELIMIT, KSC-BC-2020-06/F00219, para.4 (pika 8).

⁵⁴ Raporti i Këshillit të Evropës, Doc.12462, para. 68, 72.

të Evropës. DHSK-ja ka juridiksion lëndor për këto akuza, dhe duhen hedhur poshtë kërkesat e Mbrojtjes.

C. AFATI PËR HETIM

23. Mbeshtetja e Mbrojtjes së THAÇIT në nenin 159 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ('KPPK'),⁵⁵ është e gabuar.

24. Neni 3 i Ligjit paraqet kornizën e zbatueshme ligjore të DHSK-së. Në veçanti, aty përcaktohet se nuk zbatohen dispozita të tjera të ligjeve të Kosovës, përveçse kur janë përfshirë shprehimisht në Ligj dhe miratuar përmes tij.⁵⁶ KPPK-ja nuk është miratuar ose përfshirë në Ligj, me përjashtim të një numri të vogël referencash tejet specifike.⁵⁷ Në vend që ta përfshinte KPPK-në, Ligji përcakton se gjykatësit e DHSK-së do të hartojnë e miratojnë rregullat e procedurës dhe të provave.⁵⁸ Në këtë proces, gjykatësit do të 'drejtohen' nga KPPK-ja po nuk janë të detyruar ta zbatojnë atë.⁵⁹

25. As Rregullorja nuk e ka përfshirë nenin 159 të KPPK-së. Në vend të tij, Rregullorja përcakton një kornizë që duhet të funksionojë në përputhje me KEDNJ-në, dhe e cila kërkon që hetimi të pushojë në rast se nuk është ngritur aktakuzë brenda 'një periodhe të arsyeshme' nga momenti kur një person është bërë i dyshuar dhe

⁵⁵ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 53-59.

⁵⁶ Nenet 3(2)(c) dhe (4).

⁵⁷ Nenet 23(1), 35(3). *Shih gjithashtu* nenin 37(3)(b) (ku specifikohet se dëshmitë e dhëna në pajtim me disa dispozita të KPPK-së janë të pranueshme në DHSK).

⁵⁸ Neni 19(1).

⁵⁹ Neni 19(2).

njoftuar për një gjë të tillë.⁶⁰ Është konstatuar se ky sistem që rregullon pushimin e hetimeve,⁶¹ përputhet me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.⁶²

26. Në këtë aspekt, nuk ka paqartësi apo mangësi në Rregullore që të kërkohet zbatimi i KPPK-së.⁶³ Në këtë rast nuk është me vend as shfrytëzimi i nenit 159 të KPPK-së sepse – siç paraqitet më poshtë – një gjë e tillë do të binte në kundërshtim me Ligjin, i cili shërben si *lex specialis* i DHSK-së,⁶⁴ në vend që të ishte në pajtim me të.⁶⁵

27. Njëkohësisht, Mbrojtja e THAÇIT parashtrohet se: (i) ZPS-ja nuk lejohet të bëjë asnjë hetim për çështjet që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës, sepse çdo hetim i tillë do të duhej të ishte kryer në një kohë para vitit 2015;⁶⁶ dhe se (ii) ZPS-ja kishte

⁶⁰ Rregulla 47 e Rregullores së Procedurave dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Çdo përmendje e termit 'rregulla' ose 'rregullat' në këtë dokument i referohet Rregullores, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

⁶¹ *Contra*. Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para.55 (ku përkrahëhet në mënyrë të gabuar se kjo dispozitë përcakton se çfarë ndodh 'pas përfundimit' të hetimeve të ZPS-së; formulimi i rregullës 47 nuk e kufizon hyrjen e saj në fuqi vetëm pas përfundimit të hetimeve, përkundrazi aty përcaktohet kohëzgjatja e lejuar e një hetimi nga momenti kur njoftohet i akuzuari për këtë, dhe rrjedhimisht 'preket' nga ky njoftim). Në një parashtrim të protokolluar tjetër, THAÇI ka bërë parashtrime lidhur me hetimet e posaçme kundër tij, dhe të drejtën e tij për t'u gjykuar brenda një periudhe të arsyeshme, jo lidhur me autoritetin e përgjithshëm për hetim të ZPS-së ose afatet hetimore në përgjithësi (shih KSC-BC-2020-06/F00217), dhe ato parashtrime trajtohen me një përgjigje të veçantë.

⁶² Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, KSC-CC-PR-2017-01/F00004, 26 prill 2017, para.107.

⁶³ *Contra*. Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 54-55.

⁶⁴ Neni 3(2)(b).

⁶⁵ Rregulla 3 përcakton se Rregullorja interpretohet në pajtim me 'kornizën e përcaktuar në nenin 3 të [Ligjit], dhe nëse është e përshtatshme, me [KPPK-në]'.

⁶⁶ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 56-59 ('periudha maksimale e lejuar nga neni 159 i Kodit të Procedurës Penale është shfrytëzuar nga TFHS-ja').

kryer 'hetim penal krejtësisht të ri'.⁶⁷ Ky qëndrim është në thelb jologjik, dhe asnjë prej këtyre pretendimeve nuk qëndron nga pikëpamja e analizës logjike.

28. Nga njëra anë, sa i përket pretendimit se ZPS-ja nuk ishte autorizuar të kryente hetime apo të lëshonte aktakuza lidhur me aspekte të cilat ishin hetuar (në tërësi apo pjesërisht) prej TFHS-së, ky qëndrim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me juridiksionin që i është dhënë DHSK-së,⁶⁸ si dhe me mandatin dhe kompetencat e ndërlidhura hetimore dhe proceduese të ZPS-së,⁶⁹ me të cilat, ndër të tjera, sigurohet baza e qartë ligjore për hetime të mëtejshme në mbështetje të një aktakuze.⁷⁰ Në fakt, një kufizim i tillë do të kishte bërë që DHSK-ja të mos ishte në gjendje të funksiononte që në fillimet e saj. Do të kishin qenë të kota hetimet e mëtejshme apo ndjekja penale lidhur me aspekte të lidhura me Raportin e Këshillit të Evropës në rast se afati fundor për to, sipas Mbrojtjes së THAÇIT, do të kishte qenë 2014, koha e Shkëmbimit të Letrave, apo 2015, koha kur u ndryshua Kushtetuta dhe u miratua Ligji. Përkundrazi, është e qartë, mes të tjerave, nga vetë Shkëmbimi i Letrave, se parashihej në mënyrë të posaçme që aspekte të tilla të ndiqeshin nga një zyrë e specializuar e prokurorisë dhe para dhomave të specializuara, me qëllim që të ekzistonin garancitë e nevojshme të sigurisë, pavarësisë, paanësisë dhe drejtësisë.

⁶⁷ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para.59.

⁶⁸ Neni 6(1).

⁶⁹ *Shih, për shembull*, Ligjin, neni 35 (ku përcaktohet mandati hetimor i ZPS-së, përfshirë nenin 35(2) me anë të të cilit autorizohet ZPS-ja 'për të zhvilluar hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat gjyqësore të reja apo në proces në kuadër të juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara'); rregullat 30-47 (ku përcaktohen një numër masash hetimore dhe të drejtat e personave gjatë hetimeve), 85 (kompetenca që ka Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të marrë vendim në lidhje me kërkesat e ZPS-së që kanë të bëjnë me kryerjen e hetimeve).

⁷⁰ *Contra* Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para.53.

29. Nga ana tjetër, po të kishte nisur ZPS-ja një hetim 'krejtësisht të ri' nga ai i TFHS-së, këtë nuk do të kishte pasur mundësi ta pengonte neni 159 (edhe po të ishte i zbatueshëm, gjë që nuk është) pasi do të ishte hetim 'krejtësisht i ri'.

D. MANDATI KOHOR

30. Argumentet e Mbrojtjes së THAÇIT se DHSK-ja kishte mandat pesëvjeçar që përfundoi në gusht 2020⁷¹ shpërfillin deklaratimet e qarta të DHSGJK-së, të cilat kanë fuqi detyruese për këtë aspekt.⁷² Siç ka konstatuar më parë DHSGJK-ja, mandati kohor i DHSK-së nuk kufizohet për një periudhë pesëvjeçare.⁷³ Mandati vazhdon deri kur Këshilli i Bashkimit Evropian ta njoftojë Kosovën për përfundimin e tij.⁷⁴

31. Ky interpretim i DHSGJK-së konfirmohet posaçërisht nga Shkëmbimi i Letrave, ku përcaktohet se mandati i DHSK-së 'do të vazhdojë deri [...] kur Kosova merr njoftimin nga Këshilli i Bashkimit Evropian që hetimet kanë përfunduar si dhe çdo procedurë nga dhomat gjyqësore që rezultojnë nga ato hetime të ketë përfunduar'.⁷⁵ Sipas të gjitha dispozitave kushtetuese, në rast se hetimet dhe procedimet nuk

⁷¹ Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para. 44-52.

⁷² Neni 162(3) i Kushtetutës.

⁷³ Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, KSC-CC-2020-11/F00015, 26 nëntor 2020, para. 65-66.

⁷⁴ Aktgjykimi i DHSGJK-së mbi Amendamentin, KSC-CC-2020-11/F00015, para.66; neni 162(14) i Kushtetutës, *ku i referohet* Ligjit nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014, f.10.

⁷⁵ Shkëmbimi i Letrave, 04-L-274, f. 8; J Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, KSC-CC-2020-11/F00015, 26 nëntor 2020, para. 66. *Contra* Kërkesa e THAÇIT, KSC-BC-2020-06/F00216, para.48.

përfundojnë brenda periudhës pesëvjeçare fillestare, atëherë mandati vazhdohet deri në njoftimin në pajtim me Shkëmbimin e Letrave.⁷⁶

32. Siç ishte e qartë në atë kohë,⁷⁷ amendamenti i propozuar kushtetues – të cilin THAÇI e paraqiti pasi ZPS-ja njoftoi se kishte kërkuar konfirmim e aktakuzës kundër tij – synonte të mundësonte pikërisht këto lloj argumentesh që paraqiten tani nga Mbrojtja e THAÇIT. Vlerësohet se amendamenti i propozuar nga THAÇI pakësonte të drejtat dhe liritë kushtetuese të viktimave dhe dëshmitarëve pikërisht për shkakun se eliminonte garancitë lidhur me funksionimin ‘e sigurt, të pavarur, të paanshëm, të drejtë dhe efikas’ të DHSK-së.⁷⁸ Parashtrimet e THAÇIT janë në kundërshtim me përfundimet me fuqi detyruese të DHSGJK-së, dhe duhet të hidhen poshtë.

⁷⁶ Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, KSC-CC-2020-11/F00015, 26 nëntor 2020, para. 65-66 (‘[n]ë lidhje me këtë pikë, Presidenti i Kosovës iu referua “paqartësisë” në nenin 162(13) dhe (14), që mund të nënkuptonte se mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së ishte i kufizuar për një periudhë pesëvjeçare e cila tashmë kishte përfunduar. Sidoqoftë, Dhoma nuk mund të gjejë një interpretim të tillë të mundshëm për këto dispozita. [...] Në nenin 162(13) dhe (14) përcaktohet se në rast se nuk ka njoftim prej Këshillit për përfundimin e mandatit para përfundimit të periudhës fillestare pesëvjeçare, mandati vazhdon pas periudhës fillestare pesëvjeçare deri kur Këshilli të njoftojë Kosovën për përfundimin e mandatit. Nuk ka pasur asnjë njoftim prej Këshillit për përfundimin e mandatit para përfundimit të periudhës pesëvjeçare fillestare në bazë të nenit 162(13). Rrjedhimisht, mandati i Dhomave të Specializuara dhe i ZPS-së ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri në njoftimin prej Këshillit për përfundimin e mandatit sipas nenit 162(14).’). *Shih gjithashtu* Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Amendamentet e Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, KSC-CC-2020-11/F00008, para. 8-11.

⁷⁷ *Shih* KSC-CC-2020-11/F00008, para. 12-13 (duke iu referuar deklaratave publike të THAÇIT në kohën kur është paraqitur propozimi i amendamentit, nga para.13: ‘[d]uke sugjeruar se mandati kohor i gjykatës ka nevojë të “shtyhet” dhe “sqarohet”, z. THAÇI do të thotë se mandati i saj kishte përfunduar në gusht 2020. Pasoja e mundshme e këtij qëndrimi do të ishte shfuqizimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra nga DHSK-ja/ZPS-ja që nga ajo kohë, përfshirë veçanërisht çdo konfirmim të Aktakuzës kundër vetë z. THAÇI’).

⁷⁸ Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, KSC-CC-2020-11/F00015, 26 nëntor 2020, para. 67-69.

III. MJETI KURIDIK QË KËRKOHE

33. Për arsyet e lartpërmendura, DHSK-ja ka juridiksion për krimet për të cilat janë ngritur akuzat dhe mjeti juridik që kërkon Mbrojtja lidhur me Raportin e Këshillit të Evropës, afatet hetimore dhe mandatin kohor duhet rrëzuar në tërësi.

Numri i fjalëve (në origjinal): 4439

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E premte, 23 prill 2021
Në Hagë, Holandë.